

VENDIM
Nr.94, datë 21.12.2006

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR EKSPORTIN E ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË
“WONDER POWER” SHA

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13, pika 1 germa “d”, nenit 15, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.37, datë 9.7.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, nenet 4, pika 1 germa “f”, dhe 5, pika 1, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “Wonder Power” sh.a. për marrje licence për aktivitetin e eksportit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

I. Dhënien e licencës për eksportin e energjisë elektrike “Wonder Power” sh.a., me një afat kohor nga data 1.1.2007 – 31.12.2007.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2007 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta